

20160300795

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR PAGESËN E PENSIONEVE
DHE KOMPENSI MEVE TË PENSIONEVE NGA SIGURIMI PENSIONAL ME
FINANCIM KAPITAL

Neni 1

Në Ligjin për pagesën e pensioneve dhe kompensimeve të pensioneve nga sigurimi pensional me financim kapital ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 11/12 dhe 147/15) në nenin 28 në paragrafin (3) pika në fund të fjalisë zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: "në afat prej tre ditë nga dita e pranimi të vendimit".

Neni 2

Në nenin 34 paragrafi (2) ndryshon si vijon:

"(2) Kërkesa për realizimin e të drejtës së pensionit vetëm nga shtylla e dytë paraqitet pas mbushjes së moshës 65 vjeçare. Anëtar i fondit pensional nga paragrafi (1) të këtij neni bashkë me kërkesën nga paragrafi (1) të këtij neni paraqet deklaratë të vërtetuar në noter se heq dorë nga e drejta e pensionit nga shtylla e parë dhe nga e drejta për shumën më të ulët të pensionit. Anëtar i fondit pensional mund të zgjedhë ndërmjet:

- a) pagesës së njëfishtë të mjeteve nga shtylla e dytë nga llogaria e tij individuale ose
- b) realizimit të pensionit vetëm nga mjetet e shtyllës së dytë nëse pensioni është më i lartë ose i barabartë me 40% të shumës më të ulët të pensionit në ditën e realizimit të së drejtës për pension nga shtylla e dytë.

Pas paragrafit (2) shtohen dy paragrafë të ri (3) dhe (4) si vijon:

(3) Në afat prej tre ditëve nga dita e pranimi të kërkesës nga paragrafi (1) të këtij neni shoqëria pensionale e cila drejton me fondin pensional kërkuesi i së cilës është anëtar paraqet kërkesë te Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë që të dorëzojë vërtetim se anëtar i fondit pensional nuk ka realizuar të drejtën e pensionit për shkak të mosplotësimit të kushteve në lidhje me gjatësinë e stazhit pensional.

(4) Personi zyrtar i autorizuar nga Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë është i obliguar ta dorëzojë vërtetimin nga paragrafi (3) të këtij neni në afat prej tre ditëve nga dita e pranimi të kërkesës."

Neni 3

Në nenin 89 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Gjohë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar të autorizuar të Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë, nëse në afat prej tre ditë nga dita e pranimi të kërkesës nuk vepron në pajtim me nenin 34 paragrafi (4) të këtij ligji."

Në paragrafin (3) i cili bëhet paragraf (4) fjalët: "paragrafi (1) zëvendësohen me fjalët: "paragrafët (1) , (2) dhe (3)."

Neni 4

Procedurat e filluara deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji do të përfundojnë në pajtim me ligjin me të cilin kanë filluar.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" ndërsa do të fillojë të zbatohet me fillimin e zbatimit të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative në pajtim me nenin 141 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 124/15).